

V E N D I M
Nr. 386, datë 14.7.2000

PËR RRIJTJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996,, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, si dhe të nenit 1, të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përfitimet suplementare të ushtarakëve, të atyre që janë caktuar dhe të atyre që do të caktohen deri në datën 30.6.2000 (përfshirë edhe kjo datë), në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror” (i ndryshuar), rriten në masën 10 për qind.

2. Pensionet familjare, ato që janë caktuar dhe që do të caktohen deri në datën 30.6.2000 (përfshirë edhe kjo datë), në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit, rriten në masën 10 për qind.

3. Efektet financiare nga rritja e përfitimeve suplementare të ushtarakëve llogariten në shumën 41 500 mijë lekë dhe përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Efektet financiare, nga rritja e pensioneve familjare të familjeve në ngarkim të pilotëve, që kanë humbur jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit, llogariten në shumën 480 mijë lekë dhe përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

5. Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2000 në zërin “Shpenzime”, i shtohen 41 980 mijë lekë.

6. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Banka e Kursimeve dhe Alba Post sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta